



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 5083/Prot.

Tiranë, më 03.07.2023

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 48, datë 03.07.2023

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Avia Center" Shpk, me NUIS M22128040F, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e shërbimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar sipas faturës elektronike Nr. 17/2023, 19.01.2023, me objekt: "Bileta avioni", me vlerë 650.000 lekë (pa TVSH).

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Avia Center" Shpk, me NUIS M22128040F, me adresë: Rruga "Arkitekt Kasemi", Pallati Nr. 52, Apartamenti 2, 1015, Tiranë.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Avia Center" Shpk, ka nisur për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP, në të cilin përcaktohet se: "1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 48 datë 03.07.2023, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Avia Center" Shpk, me NUIS M22128040F, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 10 (dhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.